

UDHËZUES


PËR PËRDORIMIN NGA SUBJEKTET TË SISTEMIT TË BAZËS SË TË DHËNAVE PËR ÇMIMET E REFERENCËS (PRDB)

1. Përdorimi i Sistemit PRDB


1.1. Hyrja në Sistem

Për të përdorur Sistemin e Bazës së të dhënave për Çmimet e Referencës (PRDB) përdoruesi (subjekti) hyn në site-in <https://prdb.azhbr.gov.al>


Përdoruesit i shfaqet pamja e mëposhtme, klikon në ikonën



Shfaqet ikona “Hyr” dhe klikohet




Shfaqet dritarja me pamjen e më poshtme dhe klikohet “Regjistrohu si furnitor”



1.2. Regjistrohuni si furnitor (subjekt)

Pas klikimit në ikonën “Regjistrohu si furnitor”, shfaqet dritarja:



Përdoruesi regjistrohet si furnitor duke plotësuar fushat e mëposhtme: Emri i subjektit, NIPT, (Emri Mbiemri) i personit të kontaktit, adresa e subjektit, tipi i furnitorit, seksionin ku vepron, ngarkohen dokumentet, e-mail dhe fjalëkalimin. Pas plotësimit të fushave, klikoni te ikona “Regjistrohu”.

*Adresa e-mailit që regjistrohet do të shërbejë për hyrjen në Sistem dhe do të sigurojë komunikimin midis AZHBR-së dhe subjektit, për këtë arsye adresa duhet të jetë aktive .

Të gjitha fushat të shënuara me () janë të detyrueshme për tu plotësuar.*

1.2.1. Tipi*

Në fushën Tipi*, Furnitori duhet të zgjedhi një nga opsionet:

- a) Prodhuesi (Producer)
- b) Shpërndarës (Distributor)
- c) Tregtar (Dealer)

Shënim: Në rastin kur “Tipi” nuk përshatet me asnjë nga këto tre opsionet, përzgjedh opsionin “Other trader”.




1.2.2. Seksionet*

Në fushën Seksionet*, Furnitori duhet të zgjedhë opsionet sipas fushës së veprimtarisë të regjistruar në QKB:

- a) Makineri dhe pajisje bujqësore
- b) Mbjellje dhe shërbimet bujqësore
- c) Punimet e ndërtimit dhe rindërtimit

Shënim: Furnitori mund të përzgjedhë një ose më shumë opsione por duhet të përputhet me fushën e veprimtarisë së tij të regjistruar në QKB.





1.2.3. Dokumentat*

Në fushën Dokument*, furnitori duhet të ngarkojë Certifikatën e Regjistrimit të subjektit/ekstrakt i thjesht (QKB).

Regjistrimi bëhet aktiv pas verifikimit nga punonjësit e AZHBR-së. Vetëm pas miratimit subjekti (furnitori) mund të ketë mundësinë për të përdorur Sistemin PRDB dhe të regjistrojë ofertat e tij.


2.1. Hyrja në sistem pas regjistrimit

Pasi llogaria të jetë verifikuar dhe aprovuar nga personat përgjegjës në AZHBR, Subjekti logohet me të dhënat e regjistruara duke klikuar te butoni “Hyr” dhe shfaqet dritarja e më poshtme. Shkruan adresën e emailit me të cilën është regjistruar, vendoset “Fjalëkalimi” dhe klikohet “Hyr”



2.2. Shtimi i asetëve

Pas hyrjes në sistemin PRDB me të dhënat e regjistruara, furnitori mund të regjistrojë asetet duke klikuar mbi butonin “Shto Aset”



2.2.1. Regjistrimi i asetit

Pasi klikohet te butoni “Shto Aset”, përzgjidhet aseti i cili do të regjistrohet në fushën “Kategoria”. Skruhet emri i asetit që do regjistrohet dhe shfaqet dritarja si më poshtë:

ASET



ASET

Kategoria
Makineri dhe pajisje bujqesore (Machines and equipment) -> TRAKTOR (TRACTOR) x

Çmimi * Monedha * ▼

E vlefshme prej * E vlefshme deri *

Vetitë

Anullo Ruaj

Vendoset çmimi, përzgjidhet monedha si dhe periudha e vlefshmërisë. Pasi plotësohen këto të dhëna, klikohet mbi ikonën “kyç”-

ASET

Kategoria

Çmimi * Monedha * ▼

E vlefshme prej * E vlefshme deri *

Vetitë

Anullo Ruaj



2.2.2. Regjistrimi i vetive të asetit të regjistruar/specifikime teknike.

Pasi klikohet mbi ikonën “kyç”, hapet dritarja si më poshtë:

ASET

Kategoria
Makineri dhe pajisje bujqesore (Machines and equipment) -> TRAKTOR (TRACTOR)

Çmimi *
100001

Monedha *
EUR

E vlefshme prej *
26/9/2024

E vlefshme deri *
26/9/2024

Vetitë

Vetitë [1]ME GOMA / [2]ZINXHIRE	Vlera * 1
Vetitë STAGE I MOTORIT	Vlera * V
Vetitë FUQIA NE KW	Vlera * 30
Vetitë ME KABINE [1]PO / [2]JO	Vlera * 1
Vetitë AJER I KONICIONUAR [1]PO / [2]JO	Vlera * 2
Vetitë	

Anullo Ruaj

Plotësohen vetitë e asetit që do të regjistrohet.

Për vetitë që janë me alternativa zgjidhet njëra prej tyre (p.sh: vetitë [1]GOMA / [2]ZINXHIRE, në këto raste, kur duam të zgjedhim GOMA shënojmë [1], kur duam të zgjedhim ZINXHIRE shënojmë [2]).

Pas regjistrimit të të gjitha vetive klikohet butoni “**Ruaj**”.

Vetëm pas verifikimit dhe miratimit nga punonjësit e AZHBR-së asseti me çmimin e regjistruar nga furnitori bëhet aktiv në Sistemin PRDB.